

NJOFTIM
Nr. 1044, datë 31.1.2024

**PËR EMËRIMIN E Z. ERVIS VATA SI NËPUNËS CIVIL NË POZICIONIN
SPECIALIST NË SEKTORIN E LEJEVE MJEDISORE NË AGJENCINË RAJONALE
TË MJEDISIT TIRANË/DURRËS/DIBËR**

Në vijim të shkresës së Departamentit të Administratës Publike me nr. 6313/4 prot., datë 17.1.2024, me lëndë “Kërkesë për ndihmë administrative”, ku kërkohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit njoftimi i aktit nr. 6313/2 prot., datë 10.1.2024, për emërimin e z. Ervis Vata në pozicionin Specialist në Sektorin e Lejeve Mjedisore në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë/Durrës/Dibër, kategoria e pagës IV-b.

Bazuar në nenin 66/1, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, urdhrin nr. 5151/2015, “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit “Për shërbimin civil”, në vijim të propozimit të Komisionit të Posaçëm për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të ngritur pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, përcjellë me akt-rekomandimin nr. 39 prot., datë 3.1.2024, në zbatim të vendimit gjyqësor të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit nr. 468, datë 29.9.2021, e cila ka ndryshuar vendimin nr. 1632, datë 30.4.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë,

z. Ervis Vata

emërohet nëpunës civil në pozicionin Specialist në Sektorin e Lejeve Mjedisore në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë/Durrës/Dibër, kategoria e pagës IV-b.

Ndaj këtij akti mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të tij në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

DREJTOR DEPARTAMENTI
Enkela Dudushi